



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 26.09.2025

Ref. KM.123/2025

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 të Rregullores (QRK)-Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, (21.06.2024), nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 Shtojca 1, pika 11 të rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16.08.2023), në bazë të nenit 8, (paragrafi 8.2), të Ligjit Nr. 02/L-53 për Gjuejinë, (Gazeta Zyrtare, Nr. 8, 01 janar 2007), nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MA - NR. 11/2007 për Sezonin e Gjuejisë (datë 14 shtator 2007), Udhëzimin Administrativ (MEA) Nr.12/2020 për shpalljen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura të dt.15.12.2020, si dhe nenet 2, 3, 4, 6 dhe 11, të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr. 02/2008 Për përdorimin e armëve dhe municionit të përshtatshëm për gjueti (datë 03 mars 2008), Zëvendës Ministri në detyrë i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nxjerr:

V E N D I M

Për Hapjen e Sezonit të Gjuejisë 2025 - 2026

1. Shpallet i hapur sezoni i gjuejisë për periudhën 2025 - 2026 për lloje të caktuara të kafshëve të egra.
2. Sezoni i gjuejisë shpallet i hapur nga data 19.10.2025 (**E Diel, 19 Tetor 2025**).
3. Gjuejia do të zhvillohet në reduktimin (zvogëlimin) e llojeve të caktuara të kafshëve dhe shpezëve të egra, sipas nenit 14 të Ligjit Nr. 02/L-53 për Gjuejinë, dhe në harmoni me planet vjetore të menaxhimit me vend gjueti të aprovuara sipas legjislacionit në fuqi.
4. Aktivitetet e gjuejisë, mundë ti organizojnë vetëm menaxherët e vendgjuetive të cilët kanë të hartuar dhe aprovuara planin dhjetë vjeçarë (10) të menaxhimit të vend gjuejisë sipas nenit 42 dhe planin vjetor të menaxhimit të vend gjuejisë sipas nenit 43 të Ligjit Nr. 02/L-53 për Gjuejinë dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2008, Për përmbajtjen, mënyrën e hartimit dhe procedurat e aprovimit të planeve të menaxhimit në vend gjueti të dt. 21.03.2008.
5. Vendgjuetitë të cilat kanë të aprovuar planet vjetore të menaxhimit 2025 - 2026 janë të listuara në shtojcën e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

6. Gjahtarët mund të marrin pjesë në gjueti, nëse kanë të dhënë provimin për gjahtarë sipas nenit 11 të Ligjit Nr. 02/L-53 për Gjuetinë - Kualifikimi i gjahtarëve dhe vlerësuesve të Trofeve, dhe sipas kritereve të Udhëzimit Administrativ Nr. 23/2007, Programi për aftësimin e kuadrove në gjueti (datë 14.09.2007), si dhe të ketë lejen me shkrim nga menaxheri i vend gjuetisë.

7. Menaxherët e vendgjetive janë të obliguar që të evidentojnë dhe raportojnë për çdo kafshe të gjuajtur dhe çdo dyshim për sëmundje ngjitëse eventuale.

8. Gjuetia do të organizohet vetëm gjatë ditëve të **diela** dhe në ditët festave zyrtare sipas Ligjit Nr.03/L - 064 Për Festat Zyrtare në Republikën re Kosovës.

9. Organizimi i Gjuetisë në bazë të këtij vendimi do të bëhet nga menaxheret e vend gjuetive, si dhe nën mbikëqyrjen e organeve përgjegjëse të MBPZHR dhe të Komunës përkatëse ku zhvillohet gjuetia.

10. Gjuetia e kafshëve të egra duhet të bëhet në përputhshmëri të plotë me nenin 5, 8, 9, 10, 11 dhe 14 të Ligjit Nr. 02/L-53 për Gjuetinë, me dispozitat e Udhëzimit Administrativ MA – Nr. 11/2007, Për Sezonin e Gjuetisë si dhe në harmoni me Udhëzimin Administrativ (MEA) Nr.12/2020 për shpalljen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura të dt.15.12.2020 si dhe duke respektuar kalendarin e gjuetisë për secilin lloj të kafshëve të egra.

11. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Departamenti i Pylltarisë, Agjencia e Pyjeve të Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës (Drejtoritë Rajonale dhe Njësitë Komunale të Policisë), Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, Drejtoritë Komunale kompetente për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të Republikës së Kosovës, Federata e Gjahtarëve të Kosovës, dhe menaxheret e vendgjuetive për zbatimin e këtij Vendimi.

12. Vendimi do të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Ueb faqen e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe në media të shkruara sipas legjislacionit në fuqi.

13. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.


Lazar RADULOVIĆ

Zëvendësministër në detyrë i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Vendimi iu dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Departamentit të Pylltarisë MBPZHR;
- Agjencisë së Pyjeve të Kosovës;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës (Drejtorive Rajonale dhe Njësitë Komunale të Policisë);
- Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Drejtorive komunale kompetente për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
- Federatës së Gjahtarëve të Kosovës;
- Menaxherëve të vendgjuetive;
- KFOR-it;
- EULEX-i, dhe
- Arkivit.

Lista e Vendgjuetive të Përbashkëta që plotësojnë kriteret ligjore për të organizuar gjuetinë gjatë sezonës së hapur
_2025/2026

Nr	Komuna	Vendgjuetia <i>Emërtimi / VGJ</i>	Sipërfaqja e përgjithshme <i>Ha</i>	Plani Vjetor PMV 2025_2026			Vërejtje
				Data	Pelqimi	N.prot	
<i>N</i>	<i>Shtetja e VGJ</i>	<i>VGJ .Përbashkëta</i>	<i>madhsia.sip</i>			Arhiv	<i>Komentet</i>
1	Fushë Kosovë	Bjeshka	8 438	08.05.2025		1134/2	
2	Suharekë	Gallusha	36 099	18.06.2025		2108/2	
3	Pejë	Dubočaku	13 617	13.05.2025		1565/2	
		Podguri	13 673	13.05.2025		1566/2	
4	Lipjan	Lipjani lindje	11 677	08.05.2025		1198/2	
		Lipjan Perëndim	12 146	08.05.2025		1199/2	
5	Gjilan	Maja e gjelbër	16 680	12.05.2025		1210/2	
		Karadaku	8 904	12.05.2025		1208/2	
		Zhegoc	15 324	12.05.2025		1209/2	
6	Graçanicë	Gracanica	9 627	08.05.2025		1135/2	
7	Dragash	Sharri-Sar	8 188	29.05.2025		1625/2	
8	Ferizaj	Ferizaj	27 865	29.05.2025		1660/2	
9	Mitrovica e Jug	Shala	26 208	29.05.2025		1624/2	
10	Obiliq	Qiqavica	10 482	08.05.2025		1117/2	
11	Hani i Elezit	Kroni i Ftoftë	5 821	12.05.2025		1481/2	
12	Deçan	Lojza	8 157	29.05.2025		1659/2	
13	Shtërpcë	Canus Lupus	13 053	08.05.2025		1085/2	
14	Vushtrri	Shala	19 485	12.05.2025		1350/2	
15	Kaçanik	Qyqavica	12 878	13.05.2025		1353/2	
16	Istog	Lybeteni	18 409	08.05.2025		1163/2	
		Mokna	40 323	13.05.2025		1276/2	
		Prishtina I	18 853	08.05.2025		1194/2	
17	Prishtinë	Prishtina II	7 243	08.05.2025		1194/3	
		Prishtina III	12 036	08.05.2025		1193/2	
18	Skenderaj	Drenica	37 484	08.05.2025		1120/2	